

### Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në eurozonë ka vazhduar të karakterizohet me rritje të qëndrueshme edhe gjatë TM3 2017. Në të njëjtën periudhë, shkalla e inflacionit në eurozonë ka shënuar rritje, ndikuar kryesisht nga politika e lehtësuar monetare në eurozonë dhe rritja e çmimeve të energjisë, shërbimeve dhe të ushqimit.

Lehtësimi i kushteve të financimit, si rezultat i politikave ekspansioniste dhe masave jokonvencionale të ndërmarra nga BQE, si dhe përmirësimi i kërkesës së brendshme kanë mbështetur aktivitetin ekonomik në eurozonë. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat u karakterizuan me rritje të eksporteve, investimeve si dhe konsumit.

Rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 është mbështetur nga rritja e investimeve si dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas vlerësimeve të ASK-së, ekonomia e Kosovës është karakterizuar me një rritje të BPV-së reale prej 4.3 përqind në gjysmën e parë të vitit 2017, ndërkohë që ky trend i rritjes pritet të vazhdojë edhe në pjesën e dytë të vitit. Si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, shkalla e inflacionit deri në shtator ka arritur një normë mesatare prej 1.7 përqind.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 3.8 përqind përkatësisht 7.2 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 60.8 milionë euro deri në shtator 2017, krahasuar me bilancin prej 95.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Deficitit i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale deri në shtator ishte 154.2 milionë euro krahasuar me deficitin prej 323.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky

përmirësim i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet kryesisht rritjes më të theksuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve si dhe rritjes së të ardhurave parësore dhe dytësore, ndërkohë që deficitin në tregtinë e mallrave është rritur. Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte deri në shtator të vitit 2017 kanë shënuar rritje prej 10.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Deri në TM3 2017, sektori bankar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues (10.2 përqind), kryesisht si rezultat i lehtësimit të kushteve të kreditimit nga ana e bankave, por edhe rritjes së kërkesës për kredi. Rritja e kreditimit vazhdon të financohet qëndrueshëm nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në këtë periudhë shënuan një rritje vjetore prej 9.2 përqind.

Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2017 u zvogëluar në 6.5 përqind, përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rënie të lehtë në 0.9 përqind.

Norma e kredive joperformuese vazhdoi të përcjellë trend rënës, duke zbritur në 3.6 përqind deri në shtator 2017, përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të qëndrojnë në nivele të kënaqshme.

Me rritje të aktivitetit u karakterizuan edhe segmentet tjera të sistemit financiar, si sektori pensional, sektori i sigurimeve dhe sektori mikrofinanciar. Për sa i përket performancës, sektori pensional realizoi kthim nga investimet dukshëm më të lartë se periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, edhe sektori mikrofinanciar dhe sektori i sigurimeve u karakterizuan me rritje të profitit në shtator 2017 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>05</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>07</b>
Sektori Real-----	07
Regjistri i bizneseve -----	09
Sektori Fiskal-----	10
Sektori i Jashtëm-----	10
Sistemi Financiar-----	13
Sektori Bankar-----	13
Sektori Pensional-----	20
Sektori i Sigurimeve-----	21
Sektori Mikrofinanciar-----	23
Tregu i Letrave me Vlerë-----	26

## GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë-----	05
Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së-----	06
Figura 3. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuuesit në rritje-----	07
Figura 4. Norma e inflacionit-----	08
Figura 5. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë-----	08
Figura 6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit-----	08
Figura 7. Lëvizja e çmimeve të importit-----	09
Figura 8. Lëvizja e çmimeve të prodhimit-----	09
Figura 9. Regjistri i bizneseve-----	09
Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	09
Figura 11. Eksporti dhe importi i mallrave-----	11
Figura 12. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	11
Figura 13. Struktura e importeve sipas kategorive-----	11
Figura 14. Remitencat-----	12
Figura 15. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	12
Figura 16. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës-----	13
Figura 17. Struktura e aseteve të sektorit bankar-----	13

Figura 18. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave .....	14
Figura 19. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare.....	14
Figura 20. Kreditë sipas sektorëve ekonomik .....	15
Figura 21. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik .....	15
Figura 22. Depozitat .....	16
Figura 23. Struktura e depozitave .....	16
Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita .....	16
Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve.....	17
Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik .....	17
Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozita .....	18
Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje .....	18
Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare .....	18
Figura 30. Profiti neto i sektorit bankar .....	18
Figura 31. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar .....	19
Figura 32. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar .....	19
Figura 33. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve .....	20
Figura 34. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës .....	20
Figura 35. Asetet e sektorit pensional .....	21
Figura 36. Investimet e FKPK-së .....	21
Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve .....	22
Figura 38. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara .....	22
Figura 39. Asetet e sektorit mikrofinanciar .....	23
Figura 40. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive.....	24
Figura 41. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve .....	24
Figura 42. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar.....	24
Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar .....	25
Figura 44. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik .....	25
Figura 45. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar .....	25
Figura 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar.....	26
Figura 47. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore .....	26
Figura 48. Vlera e borxhit të emetuar.....	26
Figura 49. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë .....	27
Figura 50. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit.....	27
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së .....	06
Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës .....	27
Tabela 3. Treguesit e zgjedhur makroekonomik .....	29

**SHKURTESAT:**

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

### Eurozona dhe Ballkani Perëndimor


Gjatë TM3 2017, eurozona e vazhdoi rritjen e përshpejtuar të aktivitetit ekonomik. Përforcimi i mëtejshëm i kërkesës së brendshme në eurozonë, përmirësimi i tregut të punës si dhe rritja e kërkesës së jashtme u reflektuan pozitivisht në aktivitetin ekonomik të eurozonës. Për më tepër, politikat ekspansioniste dhe masat jokonvencionale të ndërmarra nga BQE në kuadër të programit të lehtësimit sasior lehtësuan dukshëm kushtet e financimit në eurozonë, duke mbështetur kështu zgjerimin e aktivitetit ekonomik. Rritja e besueshmërisë në stabilitetin e ekonomisë së eurozonës ndikoi që BQE të marrë vendim për reduktimin e blerjes së obligacioneve qeveritare në kuadër të programit të lehtësimit sasior duke filluar nga Janari 2018. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në TM3 2017, ekonomia e eurozonës shënoi rritje prej 2.5 përqind (figura 1). Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak, eurozona u karakterizua me rritje të BPV-së prej 0.6 përqind. Rritja e vlerës së shtuar në BPV, kryesisht nga rritja e eksporteve në Gjermani dhe Itali, u reflektua pozitivisht në rritjen e përgjithshme reale të BPV-së në eurozonë.

Në vitin 2017, BQE ka parashikuar një rritje reale të BPV-së prej 2.2 përqind dhe 1.8 përqind në vitin 2018, mbështetur kryesisht në përforcimin e eksporteve të eurozonës, politikën e lehtësuar monetare dhe avancimit në kushtet e tregut të punës. Rritja ekonomike në TM3 2017 mbeti e koncentrua në ekonomitë qendrore të eurozonës si Gjermani (2.8

përqind), Francë (2.2 përqind), Holandë (3.3 përqind), Itali (1.8 përqind) dhe Spanjë (3.1 përqind).

Në shtator 2017, norma e inflacionit arriti në 1.5 përqind, për dallim nga periudha e njëjte e vitit paraprak kur ishte 0.4 përqind. Politika e lehtësuar monetare dhe rritja e çmimeve në kategoritë kryesore si energjia, shërbimet dhe ushqimi janë reflektuar në rritje të theksuar të shkallës së inflacionit në periudhën raportuese.

Figura 1. Rritja vjetore e BPV-së në eurozonë



Burimi: Eurostat (2017)


Për vitin 2017, sipas parashikimeve të BQE-së, shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 1.5 përqind, duke u zvogëluar më tutje në 1.2 përqind në vitin 2018, e ndikuar kryesisht nga çmimet e energjisë. Lansimi i programit të gjerë stimulues që nga marsi i vitit 2016 është reflektuar në rënien e normës 12 mujore të interesit të kreditimit ndërbankar Euribor në TM3 2017. BQE-ja vazhdoi të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të rifinancimit në zero përqind (figura 2).

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017, aktiviteti kreditues në eurozonë ka vazhduar rikuperimin, duke u karakterizuar me një rritje vjetore prej 4.3 përqind.

Në këtë periudhë, ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje të kreditimit prej 2.7 përqind, përderisa kreditë për ndërmarrjet shënuan rënie vjetore prej 0.1 përqind.

Gjatë kësaj periudhe, rritja e të ardhurave në dispozicion në eurozonë mund të ketë ndikuar në rritjen e depozitave të rezidentëve në sektorin bankar në vendet e eurozonës prej 3.3 përqind. Rritje më të lartë të depozitave në këtë periudhë shënuan ndërmarrjet (6.6 përqind), pasuar nga depozitat e ekonomive familjare (3.7 përqind).

Figura 2. Norma e kreditimit ndërbankar EURIBOR dhe norma e rifinancimit e BQE-së



Burimi: Euribor (2017) dhe BQE (2017)

Aktiviteti ekonomik në Ballkanin Perëndimor gjatë TM3 2017 vazhdoi të përforcohet. Rritja e kërkesës në eurozonë, si partner kryesor tregtar për vendet në Ballkanin Perëndimor, u përkthye në përmirësim të pozicionit të neto eksporteve në disa vende të rajonit. Rritja e eksporteve, së bashku me rritjen e investimeve të huaja dhe konsumit të brendshëm, paraqitën kontribues të rëndësishëm në rritjen mesatare prej 3.4 përqind të BPV-së në Ballkanin Perëndimor për vitin 2017 (tabela 1).

Sikurse edhe në eurozonë, rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare është reflektuar në rritje të shkallës

së inflacionit në Ballkanin Perëndimor. Deri në shtator 2017, Serbia u karakterizua me shkallën më të lartë të inflacionit prej 3.2 përqind, pasuar nga Mali i Zi me shkallë mesatare prej 2.7 përqind, përderisa Maqedonia u karakterizua me shkallën më të ulët të inflacionit prej 1.0 përqind<sup>1</sup> dhe Bosnja dhe Herzegovina prej 1.2 përqind. Kosova shënoi shkallë mesatare të inflacionit prej 1.7 përqind deri në shtator 2017.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2013	2014	2015	2016	2017
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.2	3.0	3.2
Kosova	3.4	1.2	4.1	4.1	4.4*
Mali i Zi	3.5	1.8	3.4	2.9	2.7
Maqedonia	2.9	3.6	3.8	2.4	3.5
Serbia	2.6	-1.8	0.8	2.8	3.0
Shqipëria	1.0	1.8	2.8	3.4	3.7

\*Parashikim i BQK-së

Burimi: Agjensionet Statistike të vendeve përkatëse, WEO (2017) dhe parashikimi i BQK-së

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e rajonit u karakterizuan me rritje të aktivitetit kreditues prej mesatarisht 3.4 përqind në tremujorin e tretë të vitit 2017. Rritjen më të lartë e kishte Kosova me 10.2 përqind pasuar nga Mali i Zi me 7.7 përqind dhe Maqedonia 3.8 përqind. Vendet e rajonit raportuan edhe për rritje të depozitave prej mesatarisht 6.2 përqind, ku Mali i Zi shënoi rritjen më të lartë të depozitave deri në shtator 2017 (9.9 përqind), pasuar nga Maqedonia (6.0 përqind), përderisa rritjen më të ulët relative e shënoi Shqipëria (3.1 përqind).

Deri në shtator të vitit 2017, euro është zhvlerësuar kundrejt valutave si lekut shqiptar (2.5 përqind), kunës kroate (1.3 përqind), dinarit serb (0.8 përqind)

<sup>1</sup> Sipas të dhënave deri në Gusht 2017.


dhe dollarit amerikan (0.2 përqind). Ndërsa është vlerësuar kundrejt sterlines britaneze (8.8 përqind), frankës zvicerane (0.1 përqind), dhe lirës turke (22.2 përqind).

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori real

Ekonomia e Kosovës, sipas vlerësimeve të ASK-së, ka shënuar rritje të BPV-së reale prej 4.3 përqind në gjysmën e parë të vitit 2017. Kjo rritje e BPV-së është gjeneruar nga rritja e investimeve prej 15.8 përqind si dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 12.4 përqind. Siç shihet në figurën 3, investimet kanë pasur një kontribut prej 4.4 pikë përqindje në rritjen e BPV-së ndërsa neto eksportet kanë kontribuar pozitivisht me 1.0 pikë përqindje.

Figura 3. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit në rritje, në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK (2017)

Faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e investimeve në gjysmën e parët të vitit, ndër të tjera janë edhe rritja e kreditimit bankar (10.0 përqind), rritja e investimeve publike (18.7 përqind), rritja e IHD-ve (64.2 përqind), etj. Ndërsa faktorët të cilët kanë ndikuar në rritjen e eksportit të mallrave dhe

shërbimeve, ndër të tjera janë edhe rritja e çmimeve të metaleve si dhe përmirësimi i kërkesës së jashtme. Sa i përket sektorëve, rritja reale e ekonomisë së Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2017 është mbështetur kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorin e industrisë nxjerrëse (22.5 përqind), sektorin e ndërtimtarisë (20.1 përqind), aktiviteve financiare (11.8 përqind) dhe tregtisë (5.1 përqind). Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek sektori i bujqësisë (3.3 përqind), administrimit publik (2.3 përqind) dhe furnizimit me energji elektrike, gazë, ujë (1.8 përqind).

Ky trend i rritjes reale ekonomike pritet të vazhdoj edhe në pjesën e dytë të vitit 2017. Deri në muajin shtator 2017, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, norma kumulative e rritjes së eksportit të mallrave është përsheptuar në 25.9 përqind, ndërsa norma e rritjes së importit të mallrave kapitale dhe konsumuese është rritur për 3.4 përqind përkatësisht 4.7 përqind, duke reflektuar kështu rritje të kërkesës agregate. Rrjedhimisht, parashikimet e BQK-së për tërë vitin 2017 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale prej 4.4 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të kenë ndikim më të vogël negativ në BPV krahasuar me vitin e kaluar.


Rritja e aktivitetit ekonomik ka ndikuar në përmirësimin e performancës në tregun e punës në gjysmën e parë të vitit 2017. Bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore për TM2 2017, shkalla e punësimit në gjithsej popullsinë në moshë pune ka arritur në 29.9 përqind (28.0 përqind në vitin 2016). Përveç rritjes së punësimit, është rritur edhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila ka arritur në

43.0 përqind në TM2 2017 (38.7 përqind në vitin 2016). Rrjedhimisht, rritja e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila ishte më e lartë se sa rritja e punësimit, ka ndikuar në rritjen e shkallës së papunësisë, e cila ka arritur në 30.6 përqind në TM2 2017 (27.5 përqind në vitin 2016).

**Çmimet**

Deri në shtator 2017, niveli i çmimeve në Kosovë është karakterizuar me rritje. IÇK shënoi rritje mesatare prej 1.7 përqind (figura 4).

Figura 4. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, me rritje u karakterizuan çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (7.0 përqind), transportit (3.5 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.4 përqind), veshmbathjes (1.3 përqind).

Me rritje prej 1.1 përqind u karakterizuan edhe çmimet e ushqimit, që përfaqësojnë rreth 33.9 përqind të shportës së konsumatorit kosovar.

Figura 5. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek rekreacioni dhe kultura (1.4 përqind) si dhe mjetet e komunikimit (0.9 përqind) (figura 5).

Indeksi i çmimeve të importit, në TM2 2017, shënoi rritje prej 4.1 përqind (figura 6).

Figura 6. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2017)

Çmimet e produkteve bimore, produkteve minerale dhe metaleve bazë, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (14.5 përkatësisht 10.0 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujt e saj shënuan rënien më të lartë të çmimeve (4.8 përqind) (figura 7).



Figura 7. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

Indeksi i çmimeve të prodhimit u karakterizua me rënie prej 0.5 përqind. Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit, energjia elektrike, prodhimi i mobileve, etj.

Ndërsa, me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht prodhimi i metaleve, prodhimi i drurit, prodhimi i lëkurës, etj. (figura 8).

Figura 8. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2017)

### Regjistri i bizneseve

Sa i përket regjistrimit të bizneseve, deri në shtator 2017 është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara dhe numër më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Numri i ndërmarrjeve të reja të

regjistruara ishte 7,302 apo 871 ndërmarrje më pak se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2016, ndërsa u mbyllën 1,191 ndërmarrje apo 666 ndërmarrje më pak (figura 9).


Figura 9. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2017)

Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 1,951 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i hotelierisë me 747 ndërmarrje, sektori i prodhimit me 724 ndërmarrje, etj. (figura 10).

Figura 10. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2017)

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e prodhimit është shënuar rënia më e madhe e

ndërmarrjeve të reja të regjistruara prej 211 ndërmarrje më pak, pasuar nga sektori i tregtisë që u karakterizua me 200 ndërmarrje më pak të regjistruara. Sektorët kryesorë që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i aktiviteteve profesionale dhe sektori i ndërtimitarisë (88 përkatësisht 9 ndërmarrje më shumë).

### **Sektori Fiskal**

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> deri në shtator 2017 arritën vlerën neto prej 1.23 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore rreth 3.8 përqind. Në të njëjtën periudhë, shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> arritën vlerën prej 1.17 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore rreth 7.2 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 60.8 milionë euro krahasuar me bilancin prej 95.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore jo-direkte të cilat arritën vlerën prej 953.8 milionë euro (5.4 përqind rritje), ndërsa të hyrat tatimore direkte shënuan një rritje të lehtë prej 0.5 përqind dhe arritën vlerën prej 179.4 milionë euro. Rritje edhe më e lartë e të hyrave buxhetore është shënuar tek të hyrat jo-tatimore, të cilat arritën vlerën prej 138.4 milionë euro (8.8 përqind rritje).

Sa i përket shpenzimeve, pothuajse të gjitha kategoritë u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan një rritje të lehtë prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën 410.0 milionë

euro. Mallrat dhe shërbimet (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 6.0 përqind dhe arritën vlerën 137.2 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 8.9 përqind dhe arritën vlerën 349.2 milionë euro. Rritjen më të lartë e shënuan investimet kapitale të cilat arritën vlerën prej 279.8 milionë euro që janë për 18.6 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Borxhi publik arriti në 965.4 milionë euro në shtator 2017, që tregon për një rritje prej 14.6 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në rreth 15.8 përqind nga 14.3 përqind sa ishte në shtator 2015. Kjo rritje e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të jashtëm prej 15.6 përqind (vlera e të cilit ka arritur në 426.0 milionë euro) dhe borxhit të brendshëm prej 13.9 përqind (539.4 milionë euro).

### **Sektori i Jashtëm**

Deri në shtator 2017, deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 154.2 milionë euro, krahasuar me deficitin prej 323.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky deficit i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale i atribuohet kryesisht deficitit në llogarinë e mallrave. Në anën tjetër, bilancet pozitive të shërbimeve, llogarisë së të ardhurave parësore dhe llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan rritje.


Deficiti në tregtinë e mallrave u karakterizua me një rritje vjetore prej 6.4 përqind deri në shtator 2017. Eksporti i mallrave arriti vlerën prej 284.4 milionë

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN, kthimet nga fondet e depozitave, si dhe kthimi i kredive nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve.


euro, që përkon me një rritje vjetore prej 25.9 përqind (figura 11).<sup>4</sup>

Figura 11. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Rritja e vlerës së eksportit të mallrave gjatë kësaj periudhe kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të metaleve bazë, produkteve minerale, ushqimeve të përgatitura, pijeve, perimeve, etj. Në anën tjetër, me një rënie të lehtë u karakterizua eksporti i këpucëve (figura 12).


Figura 12. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 2.2 miliardë euro deri në shtator 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 8.6 përqind. Rritja e importit ishte

kryesisht rezultat i rritjes së produkteve minerale, ku përfshihet importi i naftës dhe derivateve të saj, çmimet e të cilave janë rritur në tregjet ndërkombëtare. Me rritje është karakterizuar edhe importi i mjeteve transportuese, metaleve bazë, pijeve dhe duhanit, etj. Në anën tjetër, importi i perimeve, artikujve të gurit, qeramikës, qelqit, etj. shënuan rënie (figura 13). Në shtator 2017, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ishte 12.8 përqind (11.1 përqind në shtator të vitit 2016).

Figura 13. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 703.2 milionë euro deri në shtator 2017, një rritje prej 33.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 23.5 përqind, duke arritur në 1.1 miliardë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 9.4 përqind dhe arriti në 413.1 milionë euro.


Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit përbëjnë kategorinë kryesore (85.2 përqind e gjithsej eksportit të shërbimeve) dhe shënuan rritjen më të lartë, ndërsa shërbimet e ndërtimit shënuan rënie. Sa i përket importit të shërbimeve,

<sup>4</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

shërbimet e transportit dhe shërbimet e pensionale dhe të sigurimit shënuan rënie ndërsa shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet tjera të biznesit shënuan rritje.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me rritje prej 195.8 përqind. Bilanci i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve<sup>5</sup> shënoi rritje për 10.5 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet u zvogëluar për 56.6 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 3.3 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, arritën vlerën prej 560.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind (figura 14).

Figura 14. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)


Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.2 përqind përkatësisht 22.6 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe

<sup>5</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrin e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

nga SHBA-të, gjegjësisht 7.3 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) të pranuar në Kosovë arritën vlerën prej 201.5 milionë euro deri në shtator 2017, që paraqet një rritje prej 10.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione ndërsa investimet në instrumente të borxhit shënuan rënie (figura 15).

Figura 15. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Kapitali dhe fonde i investimeve në aksione, që përbën rreth 91.2 përqind të gjithsej IHD-ve, arriti vlerën prej 183.8 milionë euro dhe shënoi rritje prej 20.0 përqind. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit arritën vlerën prej 17.6 milionë euro, një rënie prej 39.5 përqind. Rritje më e lartë e IHD-ve u shënuar në sektorin e shërbimeve financiare dhe në shërbime të tjera (30.2 përkatësisht 13.7 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar), përderisa në sektorët e patundshmërisë dhe të ndërtimit u shënuar rënia më e lartë e IHD-ve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

## Sistemi Financiar

Vlera e gjithsej asetëve të sistemit financiar të Kosovës arriti në 5.77 miliardë euro në shtator 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 10.5 përqind (figura 16).

Figura 16. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës



Kontributin kryesor në zgjerimin e asetëve të sistemit financiar vazhdojnë ta kenë rritja e aktivitetit të sektorit bankar dhe atij pensional, përderisa rritja e aktivitetit të institucioneve tjera financiare dha kontribut mjaftë të ulët si pasojë e peshës përgjithësisht të ulët të tyre në asetet e sistemit financiar.

## Sektori Bankar


### Asetet

Në shtator 2017, asetet e sektorit bankar shënuan rritje vjetore prej 8.5 përqind, duke arritur në 3.81 miliardë euro (figura 17). Rritja e asetëve të sektorit bankar vazhdon të mbështetet kryesisht në përshpejtimin e rritjes së aktivitetit kreditues.

Zgjerimi i aktivitetit kreditues të sektorit bankar vazhdon të mbështetet nga ecuria e depozitave, rritja e të cilave përbën burimin kryesor të financimit të kreditimit në vend.

Në shtator 2017, stoku i letrave me vlerë i sektorit bankar shënoi rënie vjetore prej 2.4 përqind nga 1.3 përqind sa ishte në vitin e kaluar.

Figura 17. Struktura e asetëve të sektorit bankar




Rënia në këtë kategori i atribuohet rënies prej 13.9 përqind (rritje prej 13.7 përqind në shtator 2016) të investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja, përkundër rritjes vjetore prej 12.5 përqind (rënie prej 11.3 përqind në shtator 2016) që shënuan investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës. Ngadalësimi i rritjes së investimeve në letra me vlerë të qeverive të huaja mund t'i atribuohet normave përgjithësisht të ulëta të interesit në tregjet e jashtme. Në anën tjetër, përmirësimi i vazhdueshëm i portfolios kreditore dhe kthimi më i lartë nga investimet në kredi, ka ndikuar në zhvendosjen e një pjese të investimeve nga letrat me vlerë drejtë rritjes së kreditimit.

Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në shënoi rritje vjetore të theksuar prej 18.7 përqind krahasuar me rënien prej 2.9 përqind në vitin paraprak. Rritja ishte kryesisht rezultat i rritjes së rezervave të përgjithshme të bankave komerciale të mbajtura në BQK.

### Kreditë

Kreditë e sektorit bankar vazhduan ecurinë pozitive të rritjes, duke shënuar një rritje vjetore prej 10.2 përqind në shtator 2017 (figura 18). Vlera e gjithsej kredive arriti në 2.41 miliardë euro në periudhën raportuese, kryesisht si rezultat i ofertës së lehtësuar kredituese, veçanërisht për NVM-të, e gjithashtu edhe kërkesës së rritur për kredi nga të dy kategoritë ekonomike.

Figura 18. Trendi i rritjes së kredive dhe depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2017)


Stoku i kredive ndaj ekonomive familjare vazhdon të jetë kategoria me normën më të lartë të rritjes në katër vitet e fundit. Në shtator 2017, kjo kategori shënoi rritje vjetore prej 12.2 përqind (figura 19). Ndërsa, kreditë e reja të lëshuara për ekonomitë familjare u karakterizuan me ngadalësim të rritjes. Këto kredi shënuan rritje

vjetore prej 6.0 përqind deri në shtator 2017 (15.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2016). Ngadalësimi i rritjes së kredive të reja për ekonomitë familjare u ndikua kryesisht nga rritja e ngadalësuar e portofolit të kredive të reja konsumuese.

### Kreditë ndaj ndërmarrjeve përsheptuan ritmin e rritjes në periudhën raportuese (figura 4).

Kreditë e reja të lëshuara për ndërmarrje shënuan rritje të theksuar gjatë kësaj periudhe (31.7 përqind) kundrejt rënies vjetore me të cilën u karakterizuan në vitin paraprak (18.5 përqind).

Figura 19. Kreditë e ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2017)

Struktura e kredive të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike vazhdon të mbetet e dominuar nga kreditë e destinuar për sektorin e tregtisë (figura 20).

Në shtator 2017, kreditimi i sektorëve me peshën më të madhe në ekonomi shënoi rritje (figura 21). Rritje vjetore të theksuar të stokut të kredive shënuan veçanërisht sektori i ndërtimtarisë, prodhimtarisë, tregtisë dhe kategoria e 'shërbimeve tjera', që së bashku përfaqësojnë 89.1 përqind të gjithsej kreditimit për ndërmarrjet.


Figura 20. Kreditë sipas sektorëve ekonomik, në përqindje (shtator 2017)



Burimi: BQK (2017)

Kurse, me rënie u karakterizuan sektori i shërbimeve financiare, energjetikës dhe bujqësisë, që së bashku përfaqësojnë rreth 9.0 përqind të gjithëj kreditimit të sektorit.

Figura 21. Rritja vjetore e kredive sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Kreditë e reja ndaj sektorëve ekonomik që në vitin e kaluar u karakterizuan me rënie, deri në shtator 2017 shënuan rritje të theksuar. Kontributin kryesor në rritjen e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve kishin kreditë me karakter jo-investues (40.9 përqind), pasuar nga kreditë investuese (23.6 përqind). Sipas sektorëve ekonomik, kreditë e reja ndaj sektorit të industrisë dhe shërbimeve shënuan rritje të theksuar vjetore prej 51.0 përqind përkatësisht 25.5 përqind

deri në shtator 2017. Kurse, kreditë e reja ndaj sektorit të bujqësisë për të dytin vit me radhë vazhduan trendin rënës.

*Rritja e aktivitetit të sektorit bankar deri në shtator 2017 u mbështetet nga zgjerimi i portofolit kreditor, si rezultat i përmirësimit të ofertës kreditore dhe rritjes së kërkesës për kredi. Sa i përket strukturës kreditore sipas sektorëve ekonomik, ajo vazhdoi të mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Rritje vjetore të theksuar të kreditimit gjatë kësaj periudhe kishin sektori i ndërtimtarisë, prodhimtarisë dhe i tregtisë.*

### Detyrimet dhe Burimet Vetanake


Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, që përbëjnë 79.9 përqind të gjithëj detyrimeve dhe burimeve vetanake. Depozitat vazhdojnë të jenë burimi kryesor i financimit të aktiviteteve të sektorit bankar. **Kategoria e burimeve vetanake të sektorit bankar përbënë 12.0 përqind të gjithëj detyrimeve dhe burimeve vetanake dhe në shtator u karakterizua me rritje vjetore prej 12.2 përqind**, kryesisht si rezultat i rritjes së konsiderueshme të vlerës së fitimit aktual dhe fitimit të mbajtur në 69.2 përkatësisht 105.4 milionë euro (nga 61.3 përkatësisht 68.7 milionë euro në shtator 2016).

### Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës shënuan rritje vjetore prej 9.2 përqind, ritëm ky i përshpejtuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (5.0 përqind në shtator 2016).

Vlera e gjithsej depozitave, deri në shtator 2017 arriti në 3.05 miliardë euro (figura 22).


Figura 22. Depozitat, në milionë euro



Burimi: BQK (2017)

Niveli i depozitave në sektorin bankar reflekton ecurinë e depozitave të ekonomive familjare, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej depozitave dhe në periudhën raportuese shënuan rritje vjetore prej 4.6 përqind (figura 23).

Figura 23. Struktura e depozitave, në përqindje



Burimi: BQK (2017)

Deri në shtator 2017, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje të përsheptuar vjetore prej 26.0 përqind, që mund të jetë ndikuar nga rritja e normës mesatare të interesit në depozitat për ndërmarrjet. Sipas kategorive të depozitave, depozitat e


transferueshme shënuan rritjen më të lartë të pjesëmarrjes në kuadër të gjithsej depozitave edhe pse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me periudhën e njëjtë në katër vitet paraprake. Depozitat e afatizuara po ashtu patën një rritje të lehtë në pjesëmarrje që mund t'i atribuohet rritjes deri në një masë të normës së interesit për depozitat e afatizuara për ndërmarrjet. Në anën tjetër, depozitat e kursimit zvogëluan pjesëmarrjen.

*Pas dy viteve të ngadalësimit të rritjes, depozitat në sektorin bankar, në shtator 2017, përshpejtuan ritmin e rritjes. Depozitat e transferueshme vazhdojnë të dominojnë strukturën e depozitave dhe ta zgjerojnë pjesëmarrjen, ngjashëm me depozitat e afatizuara, përderisa depozitat e kursimit zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej depozitat.*

### Normat e Interesit

Dallimi në mes të normës mesatare të interesit në kredi dhe asaj në depozita u ngushtua në 5.6 pikë përqindje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kur dallimi ishte 6.5 pikë përqindje.

Figura 24. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2017)




Norma mesatare e interesit në kredi në shtator 2017 u zvogëluar në 6.5 përqind përderisa norma mesatare e interesit në depozita shënoi rënie të lehtë në 0.9 përqind (figura 24).

### Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në shtator 2017 zbriti në 6.0 përqind nga 6.9 përqind sa ishte në shtator 2016 (figura 25).

Në kuadër të kësaj kategorie, normat e interesit si në kreditë jo investuese ashtu edhe ato investuese vazhduan trendin rënës për të pestin vit me radhë. Edhe kategoritë tjera siç janë normat e interesit për ‘mbitërheqjet’ dhe ‘linjat kreditore’ gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me rënie krahasuar me periudhën paraprake, ndërsa ato në kreditë me ‘kushte favorizuese’ u dyfishuan nga viti paraprak.

Figura 25. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në të gjithë sektorët ekonomik, shënuan rënie. Norma e interesit në sektorin e industrisë shënoi rënie më të theksuar, për dallim nga

sektori i bujqësisë dhe shërbimeve që patën një rënie të lehtë (figura 26).

Figura 26. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)

Normat e interesit në kreditë për ekonomitë familjare vazhduan trendin rënës në 7.4 përqind nga 8.0 përqind në shtator 2016.


Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit për kreditë konsumuese u zvogëluar edhe më tej në 7.7 përqind (8.2 përqind në shtator 2016), po ashtu edhe norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare zbriti në 5.9 përqind (6.4 përqind në shtator 2016).

### Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në gjithsej depozitat u zvogëluar lehtësisht kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak (figura 27).

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma mesatare e interesit arriti në 1.4 përqind nga 1.3 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Figura 27. Norma mesatare e interesit në depozita



Burimi: BQK (2017)

Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e kursimit dhe ato të afatizuara të ndërmarrjeve prej 0.3 pikë përqindje përkatësisht 0.1 pikë përqindje (figura 28).

Figura 28. Norma mesatare e interesit në depozitat për ndërmarrje, sipas kategorive




Burimi: BQK (2017)

Po ashtu, norma mesatare e interesit në depozitat e ekonomive familjare mbeti pothuajse e njëjtë si në periudhën paraprake, në 0.9 përqind.

Norma mesatare e interesit në depozitat e transferueshme dhe të afatizuara mbeti pothuajse e njëjtë, përderisa norma mesatare e interesit në depozitat e kursimit shënoi rënie të lehtë (figura 29).

Figura 29. Norma mesatare e interesit në depozitat për ekonomitë familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2017)

### Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar kishte performancë pozitive financiare me rritje të përsheptuar vjetore të profitit, si rezultat i rritjes më të shpejte të të hyrave të sektorit krahas zvogëlimit të shpenzimeve.

Vlera e profitit të realizuar deri në shtator 2017 ishte 69.1 milionë euro, që përbën një rritje vjetore prej 12.8 përqind (figura 30).

Figura 30. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2017)

Të hyrat e sektorit bankar ndërprejnë trendin rënës të tre viteve të fundit. Deri në shtator 2017, vlera e të hyrave arriti në 181.6 milionë

euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.6 përqind (figura 31). Rritja e të hyrave kryesisht i atribuohet rritjes së të hyrave nga jo-interesi, më saktësisht të hyrave tjera operative dhe atyre nga tarifat dhe komisionet. Përderisa, trendi rënës i të hyrave nga interesi vazhdoi për të pestin vit më radhë pavarësisht aktivitetit kreditor të shtuar të sektorit.. Ky zhvillim mund t'i atribuohet rënies së vazhdueshme të normës mesatare të interesit në kredi, ku 94.9 përqind e të hyrave nga interesi gjenerohen nga interesi në kredi.

Vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar arriti në 112.5 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 1.3 përqind (figura 31).




Zvogëlimi i gjithsej shpenzimeve ishte si rezultat i rënies së shpenzimeve nga jo-interesi dhe atyre të interesit në masë më të vogël. Në kuadër të kategorisë së shpenzimeve të jo-interesit, provizionet për humbje nga kreditë ishte kategoria që shënoi rënie vjetore.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit u përmirësua, duke rënë në 61.9 përqind, si rezultat i përmirësimit të performancës së bankave në

arkëtimin e të hyrave dhe menaxhimin më të mirë të shpenzimeve (figura 16).

Rritja e theksuar e profitit të sektorit bankar në shtator 2017 u përcoll me përmirësim të të dy indikatorëve të profitabilitetit si kthimi në mesataren e asetëve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK). KMA u rrit në 2.6 përqind, ndërsa KMK u rrit në 23.0 përqind, e që nënkupton menaxhim më efikas të asetëve, respektivisht kapitalit nga ana e sektorit bankar (figura 32).

Figura 32. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar




### Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar regjistroi rënie të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese, deri në shtator 2017, shënoi rënie në 3.6 përqind, një shkallë e ulët krahasuar me vendet në Ballkanin Perëndimor dhe vendet në eurozonë (figura 33).

Për më tepër, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u përmirësua edhe më tej duke arritur në 139.9 përqind, kryesisht si pasojë e

rënies së theksuar të vlerës së kredive joperformuese në periudhën raportuese, përderisa provizionet përkundër rënies së kredive joperformuese nuk u zvogëluan në atë masë të theksuar.


Figura 33. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Burimi: BQK (2017)

Pavarësisht rënies së lehtë të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, sektori bankar vazhdon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit. Ky tregues ishte për 0.5 pikë përqindje më i ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak si pasojë e rritjes më të lartë të aseteve të peshuara me rrezik kundrejt kapitalit.

Figura 34. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Burimi: BQK (2017)

Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në krahasim me vitin paraprak. Në këtë zhvillim ndikoi rritja e detyrimeve afatshkurtra, që reflekton pjesëmarrjen më të lartë të depozitave të transferueshme në kuadër të gjithsej depozitave. Megjithatë, sektori bankar vazhdon të shfaqë pozicion të kënaqshëm të likuiditetit (figura 34).

Deri në shtator 2017, sektori bankar shënoi rritje të theksuar të profitit si rezultat i rritjes së të hyrave dhe zvogëlimit të shpenzimeve. Niveli i kredive joperformuese është mjaftë i ulët krahas mbulueshmërisë së lartë të tyre me provizione. Po ashtu, sektori bankar vijon të ketë nivel të lartë të kapitalizimit dhe pozitë të kënaqshme të nivelit të likuiditetit.


### Sektori pensional

Sektori pensional vazhdon të ketë një pjesëmarrje të lartë prej 27.5 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar. Deri në shtator 2017, asetet e sektorit pensional u zgjeruan për 14.3 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në shtator 2017, vlera e gjithsej aseteve të sektorit pensional arriti në 1.58 miliard euro, që kryesisht është reflektimi i rritjes së kontributeve të reja dhe kthimit në investime gjatë vitit aktual (figura 35).

Vlera e arkëtimeve të reja deri në shtator të vitit 2017 arriti në 117.9 milionë euro, krahasuar me vlerën prej 113.6 milionë euro deri në shtator të vitit 2016. Vlera e arkëtimeve të reja të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-së), deri në shtator 2017 arriti vlerën në 117.6 milionë

euro, kurse ajo e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP-së) në 365.4 mijë euro.

Figura 35. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK (2017)

**Sektori pensional arriti vlerë rekorde të kthimit nga investimet në këtë periudhë, që nga fillimi i operimit në vend. Deri në shtator 2017, fondet realizuan kthim në investime prej 66.8 milionë euro, për dallim nga kthimi prej 56.2 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Në këtë periudhë, FKPK realizoi kthim pozitiv në investime prej 66.4 milionë euro, ndërsa FSKP prej 349.4 mijë euro. Përmirësimi i ndjeshëm i tregueseve kryesore ekonomike në SHBA, Evropë dhe Azi, stimuluan rritjen e fitimeve për tregun global të aksioneve, gjë e cila u reflektua edhe në investimet e jashtme të fondit.

**FKPK, që përbën 99.5 përqind të aseteve të sektorit pensional, vazhdon të ketë të investuara pjesën më të madhe mjeteve jashtë vendit.** Investimet e FKPK-së jashtë vendit arritën vlerën prej 1.44 miliardë euro (1.22 miliardë euro në shtator 2016). Kurse, investimet në sektorin e brendshëm shënuan rënie, si rezultat i zvogëlimit të

kategorisë së letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe mjeteve të mbajtura në BQK.

Figura 36. Investimet e FKPK-së, milionë euro



Burimi: FKPK (2017)

Të vetmet kategori që shënuan rritje në kuadër të sektorit të brendshëm ishin investimet në sektorin bankar - certifikatat e depozitit dhe para e gatshme e mbajtur në trezor (figura 36).

*Sektori pensional po vazhdon të karakterizohet me rritje të theksuar të aseteve, rezultat i kontributeve të reja dhe kthimit pozitiv në investime. Mbi 90 përqind e mjeteve vazhdojnë të jenë të investuara në sektorin e jashtëm (fonde investuese); përderisa mjetet e mbajtura në vend, kryesisht janë të investuara në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës dhe në bankat komerciale – certifikata të depozitit.*


### **Sektori i sigurimeve**

**Sektori i sigurimeve, si komponent tjetër i rëndësishëm në kuadër të sistemit financiar, në shtator 2017 kishte një pjesëmarrje prej 3.0 përqind në gjithsej asetet.**

Në shtator 2017, vlera e gjithsej aseteve të sektorit të sigurimeve arriti në 173.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.3 përqind (figura 37).

Kontributin kryesor në rritjen e asetëve të sektorit e kishte paraaja e gatshme e mbajtur në bankat komerciale në vend, kategori e cila përfaqëson më shumë se gjysmën e gjithsej asetëve të industrisë së sigurimeve.

Figura 37. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2017)

Sigurimet jo-jetë, të cilat përfaqësojnë pjesën më të madhe të sektorit me 89.1 përqind të gjithsej asetëve, shënuan rritje vjetore prej 2.8 përqind në shtator 2017. Ndërsa, pjesa e mbetur e sektorit e përfaqësuar nga sigurimet 'jetë', shënuan rritje më të theksuar vjetore prej 18.0 përqind.

**Deri në shtator 2017, vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve arritën vlerën prej 65.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.1 përqind.** Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 97.1 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara. Vlera e realizuar e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 64.0 milionë euro deri në shtator 2017 (2.3 përqind rritje), kurse vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jetë u karakterizua me rënie vjetore prej 1.6 përqind duke zbritur në 1.9 milionë euro.

**Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e kompanive të sigurimit dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), arritën në 32.4 milionë euro deri në shtator 2017 (27.7 milionë euro deri në shtator 2016), që paraqet një rritje të theksuar vjetore prej 17.2 përqind (rënie prej 0.4 përqind deri në shtator 2016).**

Figura 38. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2017)

Rritja e lartë e dëmeve të shkaktuara gjatë kësaj periudhe, në prani të rritjes së ulët të primeve të arkëtuara, ka ndikuar në rritjen e raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara. Në shtator 2017, ky raport u rrit për 6.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në 49.2 përqind. Kjo nënkupton që pothuajse gjysma e të ardhurave nga primet e shkruara i dedikohen pagesës së dëmeve të ndodhura (figura 38).

### Performanca e sektorit të sigurimeve

**Sektori i sigurimeve deri në shtator të këtij vitit u karakterizua me performancë pozitive dhe përmirësim të indikatorëve të profitabilitetit.**

Të hyrat neto nga primet të sektorit të sigurimeve deri në shtator 2017 arritën vlerën prej 57.2 milionë

euro, përderisa shpenzimet shënuan vlerën prej 31.0 milionë euro. Si rrjedhojë e rënies më të theksuar të shpenzimeve, krahas rritjes së lehtë të hyrave, sektori i sigurimeve regjistroi profit prej 3.2 milionë euro deri në shtator 2017, krahasuar me humbjet prej 12.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së shënuar në kuadër të sigurimit 'jo-jetë' (prej 2.9 milionë euro), përderisa me performancë pozitive u karakterizua edhe sigurimi 'jetë' (prej 270.2 mijë euro).

**Rritja më e lartë vjetore e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (prej 14.2 përqind), krahasuar me rritjen më të ulët të rezervave teknike (prej 7.8 përqind), u reflektuan në përmirësimin e nivelit të likuiditetit të sektorit.** Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike u përmirësua në 82.8 përqind në shtator 2017 (78.2 përqind në shtator 2016), po ashtu raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve u përmirësua në 74.6 përqind (70.2 në shtator 2016).

---

*Sektori i sigurimeve gjatë kësaj periudhe raportuese u karakterizua me rritje të aktivitetit dhe përmirësim të performancës financiare. Kjo industri u karakterizua me rritje të nivelit të primeve të shkruara dhe zvogëlim të shpenzimeve, që rezultoi në profit pozitiv deri në shtator 2017. Po ashtu, kjo industri përmirësoi nivelin e likuiditetit, krahasuar me periudhën paraprake.*


---

## Sektori mikrofinanciar

### **Asetet**

**Institucionet mikrofinanciare përfaqësojnë sektorin e tretë më të rëndësishëm në kuadër të sistemit, me pjesëmarrje prej 3.2 përqind në gjithsej asetet.** Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2017, vlera e gjithsej asetëve të sektorit mikrofinanciar arriti në 182.0 milionë euro, duke shënuar rritje të theksuar vjetore prej 29.3 përqind (figur 39).

Figura 39. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2017)

Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, që u financua kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (67.7 përqind të gjithsej asetëve) dhe huazimet në sektorin e brendshëm (6.8 përqind të gjithsej asetëve).

### **Kreditë**

Vlera e gjithsej kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare në shtator 2017 arriti në 135.1 milionë euro, që paraqet një rritje të theksuar vjetore prej 31.1 përqind (figura 40).


Figura 40. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive



Burimi: BQK (2017)

Ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 65.1 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, u karakterizuan me rritje vjetore prej 26.6 përqind. Përderisa, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 34.9 përqind të gjithsej kredive të sektorit, shënuan një rritje vjetore prej 40.4 përqind.

Figura 41. Rritja e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2017)


Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, vlen të theksohet që për të dytin vit me radhë, kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve ekonomik u karakterizua me rritje dyshifrore. Sektorët me rritjen më të lartë ishin ai i 'sektorëve tjerë', pasuar nga

sektori i industrisë, ndërtimtarisë dhe i bujqësisë (figura 40).

### Lizingjet

Deri në shtator 2017, lizingjet shënuan rritje vjetore prej 10.6 përqind, duke ndërprerë trendin rënien të shënuar në dy periudhat paraprake. (figura 42).

Figura 42. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2017)


Në rritjen e lizingjeve kontribuoi rritja e kategorisë së 'lizingjeve tjera' (për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare) dhe kategorisë 'hipotekare' (për ekonomitë familjare), që shënuan rritje vjetore prej 22.6 përqind, përkatësisht 5.6 përqind në shtator 2017.

### Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të ngjashme me vitet paraprake. Në shtator 2017, norma mesatare e interesit qëndroi në 22.5 përqind (22.3 përqind në shtator 2016).




Figura 43. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëlua për 0.2 pikë përqindje, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rritje prej 0.8 pikë përqind (figura 43).

Figura 44. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik




Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve rezulton të ketë normën më të ulët të interesit në kredi, mirëpo me trend rritës në dy vitet e fundit. Ndërsa, sektori i industrisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi (figura 44).

## Performanca e sektorit mikrofinanciar

Deri në shtator 2017, sektori mikrofinanciar realizoi profit në vlerë prej 6.1 milionë euro, që është për 2.9 milionë më shumë kundrejt vitit paraprak (figura 45).


Figura 45. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave, më konkretisht atyre nga interesi, që përfaqësojnë 85.1 përqind të gjithë të hyrave. Po ashtu, ndikim në rritje, por me efekt më të ulët, kishin edhe të hyrat nga jo-interesi, që përfaqësojnë 14.9 përqind të gjithë të hyrave të sektorit mikrofinanciar (figura 44). Rritja e të hyrave nga interesi (për 31.6 përqind) ishte rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare, veçanërisht në dy vitet e fundit. Në anën tjetër, rritja e të hyrave nga jo-interesi (për 14.3 përqind) i atribuohet arkëtimit nga të ardhurat tjera operative.

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë këtyre nëntë muajve të vitit 2017, treguesit e profitabilitetit shënuan përmirësim të ndjeshëm (figura 46).


Figura 46. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



\*Për vitin 2017 profiti është anualizuar me performancën deri në Shtator 2017  
Burimi: BQK (2017)

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.

Figura 47. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë



Burimi: BQK (2017)


Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë në shtator 2017 u zvogëlua për 1.0 pikë përqindje kundrejt vitit paraprak duke rënë në 2.8 përqind (figura 47). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në shtator 2017 qëndroi në nivel prej 185.0 përqind krahasuar me nivelin prej 169.8 përqind në shtator 2016.

Sektori mikrofinanciar gjatë kësaj periudhe u karakterizua me rritje të theksuar të aktivitetit kreditues, pavarësisht nivelit të lartë të normave të interesit. Poashtu, sektori deri në shtator 2017, u karakterizua me përmirësim të tregueseve kyç të profitabilitetit dhe cilësisë së portofolit kreditor.

### Tregu i letrave me vlerë

Departamenti i Thesarit, në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës, deri në shtator 2017, realizoi gjithsej 14 ankande, duke arkëtuar të hyra në vlerë prej 300.0 milionë euro (figura 48). Vlen të theksohet që gjatë muajit gusht 2017, për herët të parë është realizuar ankandi për fletë-obligacione qeveritare me afat maturimi për 7 vite.

Figura 48. Vlera e borxhit të emtuar, rritja vjetore



Burimi: BQK (2017)

Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri dhe vlera e arkëtuar nga emetimi i bonove të thesari u zvogëlua ndjeshëm, përderisa numri dhe vlera e arkëtuar nga emetimi i fletë-obligacioneve u rrit (tabela 2).


**Tabela 2. Numri dhe vlera e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës**

Periudha	Bonot e thesarit		Fletëobligacionet	
	Numri i realizuar	Vlera e pranuar	Numri i realizuar	Vlera e pranuar
Janar-Shtator 2014	13	265.2	3	37.0
Janar-Shtator 2015	11	213.6	5	85.0
Janar-Shtator 2016	9	195.0	6	140.0
Janar-Shtator 2017	6	140.0	8	160.0

Burimi: MF (2017)

Sipas afatit të maturimit, rritja e numrit të fletëobligacioneve të emetuara që bartin afat më të gjatë të maturimit u reflektua në rritje të afatit mesatar të maturimit të portfolios së letrave me vlerë (figura 49).

**Figura 49. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje**




Burimi: BQK (2017)

Kategoria kryesore në strukturën e letrave me vlerë vazhdon të mbetet ajo e bonove të thesarit me afat maturimi 364 ditë dhe fletë-obligacionet me afat maturimi 2 vite, të cilat ngushtuan pjesëmarrjen krahasuar me periudhën paraprake. Kurse, fletë-obligacionet me afat maturimi 5 vite, ishin kategoria me rritjen më të madhe deri në shtator 2017, në strukturën e gjithsej letrave me vlerë.

Ngjashëm me periudhat paraprake, shumica e ofertuar nga pjesëmarrësit tejkaloi shumën e shpallur në

ankande nga Ministria e Financave. Raporti i ofertës ndaj kërkesës ishte për 1.66 herë më i lartë deri në shtator 2017 (2.23 herë më i lartë deri në shtator 2016).

**Figura 50. Normat e interesit të letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturimit, në përqindje**



Burimi: BQK (2017)

Deri në shtator 2017, tregu i letrave me vlerë, për të dytin vit me radhë, u karakterizua me rënie të normave të interesit për secilën nga kategoritë e maturimit të bonove të thesarit (deri në 1 vit) dhe fletë-obligacioneve (mbi 1 vit) (figura 50).

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2017): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 20 TM3 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2017):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2017):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2017): Metal Prices database.

FAOUN (2017): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:  
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2017): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2017): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2016	Shtator 2017
Sektori real 1/		
PBB (në milionë euro)	-	-
Çmimet (mesatarja vjetore)	0.1%	1.7%
Çmimet (fondi i periudhës)	0.5%	1.7%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,184.3	1,228.8
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,089.1	1,168.0
Bilanci primar (në milionë euro)	95.1	60.8
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,216.0	5,765.2
prej të cilave: Bankat	3,512.7	3,811.4
Kredi	2,184.4	2,407.2
Depozita	2,789.5	3,046.9
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.5	6.5
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.0	0.9
Hendeku i normës së interesit	6.5	5.6
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-323.2	-154.2
prej të cilave: remitencat e pranuar	504.5	560.7
Llogaria financiare	-32.1	-145.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	182.3	201.5
Investimet portfolio, net	259.7	-90.5
Investimet tjera, net	-204.1	-114.6
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve, net*	-61.7	-52.5
Asetet	4,475.9	4,844.3
Detyrimet	4,537.6	4,896.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,015.1	2,173.5
Borxhi i jashtëm privat	1,550.3	1,663.0
Borxhi i jashtëm publik	453.4	510.5

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

\* Për PNI dhe borxhin e jashtëm të dhënat janë deri në qershor 2017.

